

## KONCEPTIMET E PROGRESIT NË KONTEKSTIN E DOKTRINAVE EPISTEMOLOGJIKE LETRARE

**ARBEN HOXHA**

Instituti Albanologjik i Prishtinës, Dega e Letërsisë, Rr: “Eqrem Çabej”, Prishtinë, 10000, KOSOVË  
E mail: arbenhoxha69@yahoo.com

### **Përmbledhje**

Epistemologjia letrare, si metashkencë e shkencës letrare, përbën tërësinë e shpjegimeve filozofike e metodologjike të çështjes së origjinës, funksionit, zhvillimit, vlerës dhe mënyrës së verifikimit të zhvillimit të njohjeve të veçanta letrare dhe të marrëdhënieve të tyre, si: të teorisë së letërsisë, të kritikës letrare, të historisë së letërsisë; të koncepteve, të metodave, të metodologjive dhe të modeleve metodologjike letrare. Duke qenë mbi njohjet e veçanta, epistemologjia letrare është e interesuar rreth pyetjeve më të përgjithshme, si: për esencën e njohjes letrare, për burimet e njohjes, për objektivat e njohjes, për karakterin e njohjes, për mundësitë e njohjes, për kufijtë e shtrirjes së njohjes letrare etj. Në këtë punim për objekt trajtimi kemi marr *progresin*, si botëkuptim për botën dhe si parim epistemologjik të zbatuar në shkencën letrare shqipe. Për të parë karakterin dhe përmbajtjen e tij, në këtë punim progresin do ta vështrojmë në kontekstin e raportit të teorisë e metodave letrare, dhe në kontekstin e doktrinave epistemologjike letrare shqipe. Përcaktimi i konceptit të progresit – si botëkuptim për botën dhe si parim epistemologjik – në shkencën letrare shqipe, na ndihmon të hedhim dritë mbi rolin që kanë luajtur episodet e njohjes letrare në ngritjen e shkallës së racionalitetit shkencor apo, e kundërta, për të hedhur dritë rreth ndikimit të atyre episodeve në rritjen e anomalive epistemologjike letrare.

**Fjalët çelës:** Progresi, kriteret, epistemologjia letrare, anomalia epistemologjike, doktrina epistemologjike.

### **Hyrje**

Debatet për dhe rreth metodave, teorisë dhe disiplinave në fushën e dijeve shkencore kanë qenë të pranishme dje dhe vazhdojnë të jenë të pranishme edhe sot. Dhe për aq sa njeriu do të përballet me fenomenin e shpërputhjes ndërmjet mjeteve njohëse,

qëllimeve dhe funksionit praktik të tyre në jetën njerëzore, mund të thuhet se për aq do të vazhdojnë debatet për dhe rreth metodave, teorisë dhe disiplinave njohëse edhe në të ardhmen. Në zhvillimin e njohjes njerëzore nuk kanë qenë qëllimet ato që i kanë përcaktuar dallimet në mes të njohjes (joshkencore) të “njeriut arkaik” (Jung) dhe njohjes (shkencore) të “njeriut modern”, por mjetet njohëse, me anë të të cilave ata kanë synuar t’i zotërojnë *qëllimet* e tyre njohëse, dhe nëpërmjet të cilave ata i kanë ndryshuar, zgjeruar dhe përsosur cilësisht përmbajtjet e atyre qëllimeve në faza dhe periudha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Në qoftë se mund të flitet për “përhershshmërinë” e raportit të zhdrejtë ndërmjet mjeteve dhe qëllimeve njohëse, një gjë e tillë nuk mund të thuhet edhe për mjetet e së njëjtës klasë apo klasëve të ndryshme që zbatohen brenda një sistemi të caktuar njohës.

### **Ndërvlerësia e metodave dhe teorisë me pikënisjen filozofike**

Ndërmjet teorisë dhe metodave, si entitete të veçanta epistemologjike, ekziston raport i ndërsjellë. Në qoftë se teoria e ndihmon hulumtuesin që të mos e humbë rrugën në mes të fakteve, metoda e ndihmon atë që t’i klasifikojë dhe sistematizojë faktet sipas rëndësisë dhe funksionit të tyre njohës. Një teori e mirë dhe efikase e parashikon një ligj, një parim, një fenomen, një proces, një marrëdhënie, një strukturë; ndërkaq, nëpërmjet metodës bëhet i mundshëm organizimi dhe shpjegimi i materialit të atij ligji, parimi, fenomeni, procesi, marrëdhënieje dhe strukture. Teoria i definon konceptet, metoda koncepteve u jep funksione. Teoria e mundëson shpjegimin, interpretimin e fakteve, proceseve, fenomeneve, strukturave, ndërkaq metoda e përcakton masën e realizimit të fuqije parashikuese të teorisë.

Simetria strukturore e teorisë me metodën e përcakton edhe simetrinë strukturore ndërmjet interpretimit, vlerësimit dhe parashikimit të fenomeneve, proceseve dhe rrjedhave letrare. Duke u udhëhequr prej konceptonesh të ndryshme për progresin - si botëkuptim për botën dhe si parim epistemologjik - në gjysmën e dytë të shek. XX në mendimin kritik letrar shqiptar do të zhvillohen debate ndërmjet ithtarëve të dy paradigmeve kundërshtuese: paradigme pozitivist me bazë *doktrinën epistemologjike të holizmit utopik* në njërin anë, dhe dy paradigmeve postpozitivist: a) paradigme me bazë *doktrinën epistemologjike të holizmit dialektik* dhe b) paradigme me bazë *doktrinën epistemologjike të individualizmit antidialektik e antihistorik*, në anën tjetër<sup>40</sup>.

Në këto debate diferencimi i ithtarëve të paradigmeve kundërshtare sipas përmbajtjes që ata do t'ia atribuojnë progresit - si botëkuptim për botën dhe si parim epistemologjik - do të bëhet në bazë të kriterit metodologjik: kriterit të metodave dhe teorive të zbatuara. Pra, varësisht nga metodat dhe teoritë e zbatuara në metodologjinë e kritikës letrare shqipe do të cilësohet karakteri pozitivist apo postpozitivist i një paradigme.

A është i drejtë një kriter i tillë për përcaktimin e progresit të kritikës letrare shqipe?

Në strukturën e trajtimeve të ndryshme të hulumtimit shkencor mund të shfrytëzohen të njëjtat ose metodat të përafërta. Por, kjo nuk mund të thuhet edhe për zbatimin e paradigmeve shkencore, struktura e të

cilave fundamentalisht përcaktohet prej hipotezave të kundërta filozofike. "Filozofia – thotë Dëlëze – është plan konsistence ose më saktësisht plan i imanencës së koncepteve, planomen. Koncepti dhe plani janë të ndërlidhur në mënyrë strikte" (Deleuze, 2008: 49). Metoda e teorisë të ndryshme mund të bashkëkrijojnë e bashkëvëprojnë brenda një paradigme për aq sa ato do të jenë në përputhje dhe në shërbim të hipotezës filozofike, por në dijen shkencore është e pamundur që paradigma të ndryshme, që bazohen në hipoteza filozofike të ndryshme, të bashkëkrijojnë e bashkëfunksionojnë (Lincoln, 2000: 169).

Pse themi kështu? Themi kështu sepse paradigmat nuk janë modele të thjeshta me anë të të cilave shpjegohen fenomene të caktuara në botë, por struktura shënjuese të pikëpamjeve dhe të vizioneve për botën. Në qoftë se themi se është e vështirë që të krijohet një pajtueshmëri ndërmjet pikëpamjes pozitivist për botën me, ta zëmë, pikëpamjen strukturaliste apo poststrukturaliste për botën, një gjë e tillë nuk mund të thuhet edhe për raportin ndërmjet metodave dhe teorive të ndryshme që vihen në të njëjtin plan imanence dhe në shërbim të tij. Varësisht se a do të bazohet në kriter metodologjike (teori dhe metoda) apo në kriter filozofike e epistemologjike, në shkencën letrare shqipe do të përcaktohen përmbajtjet e konceptioneve për progresin.

Në gjysmën e dytë të shek. XX, beteja që do të zhvillohet për mbizotërimin e paradigmeve postpozitivist - e cila do të udhëhiqet nga ideja për ekzistencën e shumësisë së metodave dhe teorive duke anashkaluar pikënisjen filozofike (planin e imanencës së tyre) dhe *qëllimin* njohës (fenomen ky që do të ndodhë në Kosovën e vitet '70-të) – do të jetë beteje që, më shumë se sa do të hedhë dritë mbi çështje të mendimit teorik letrar, në shkencën letrare shqiptare do të përhapë, siç do të thoshte Ogyst Konti, kaosin intelektual, apo ndryshe do të mund ta qanin fenomenin e anomisë epistemologjike. Ndërkaq, beteja për mbizotërimin e paradigmeve pozitivist, e cila do të bazohet në kriterin e arritjes së qëllimit përfundimtar të vendosur në bazë të doktrinës filozofike të marksizëm-leninizmit - duke anashkaluar natyrën e lëndës letrare të njohjes dhe duke shpërfillur lëndën dhe hipotezën, si përbërës të sistemeve të teorive dhe të metodave, të cilat do jenë pretenduese të zotërimit të lëndës së njohjes letrare (siç ka ndodhur në Shqipërinë komuniste) - do ta skematizojnë mendimin kritik për letërsinë dhe do ta shndërrojë atë në sektor të ideologjisë mbizotëruese. Një filozofi i tillë, si planomen, që do të marrë pozicion mbrojtës ndaj koncepteve, metodave dhe teorive, vetveten do ta fusë në krizë. Dhe "kriza e filozofisë – thotë Edmund

<sup>40</sup> Me sintagmën terminologjike "doktrinën epistemologjike letrare" kuptojmë tërësinë e parimeve të caktuara teorike letrare, të cilat bazohen dhe janë në varësi me vizionet ndaj botës, e me këtë edhe me pikëpamjet e caktuara për letërsinë, si pjesë përbërëse të atyre vizioneve. Ndërkaq, togfjalëshat terminologjikë "doktrina holiste utopike" dhe "doktrina holiste dialektike" nominalisht janë adaptime të togfjalëshave terminologjikë: "inxhinieria utopike" dhe "inxhinieria e pjesë-pjesëshme", të cilët i përdor Karl Poperi në veprën "*Mjerimi i historicizmit*" (Tiranë, Onufri, 2003, fq. 74-79). Dallimi ndërmjet këtyre dy doktrinave epistemologjike ka të bëjë me konceptet që ato përfaqësojnë në relacion me konceptin e "tërësisë". Derisa "doktrina e holizmit utopik" "tërësinë" do ta konceptojë si shumë të pjesëve, "doktrina e holizmit dialektik" "tërësinë" do ta konceptojë si lidhje strukturore ndërmjet pjesëve me tërësinë dhe anasjelltas. Për sqarim, duhet theksuar se Poperi i bën kritikë të ashpër doktrinës epistemologjike të "inxhinierisë utopike", por ka qëndrim pozitiv dhe afirmues ndaj doktrinës së "inxhinierisë së pjesë-pjesëshme". Togfjalëshat që kemi përdorur ne me togfjalëshat që përdor Poperi dallojnë për shkak të natyrës së objektit që shënjojnë dhe dimensionit të ri semantik që ato marrin në dritën e tij.

Huserl – simbolizon krizën e të gjitha shkencave bashkëkohore, si pjesë e karakterit të gjithmbarshëm të filozofisë...Në fillim kjo është një krizë latente, e pastaj gjithnjë e më tepër krizë...në tërë përmbajtësinë e jetës kulturore të tij, në tërësinë e “ekzistencës” së tij” (Huserl, 1984: 133).

### **Kriteri epistemologjik i progresit**

Zhvillimi i kritikës letrare shqipe gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX do të marrë orientimin e vet në bazë të tri kriterëve (që do të jenë përcaktuesit e përmbajtjes së koncepcioneve) për progresin: sipas kriterit metodologjik, mbi bazën e të cilit do të bëhet vlerësimi sinkronik i teorive, në masën që ato do t’u përgjigjen problemeve të shfaqura në një moment të caktuar; sipas kriterit epistemologjik, mbi bazën e të cilit do të bëhet e mundur vlerësimi diakronik i shkallës së efikasitetit të zgjidhjes së problemeve në perspektivën historike dhe në përputhje me nevojën e rritës në maksimum të numrit të episodeve racionale në procesin e njohjes letrare; dhe sipas kriterit ideologjik, mbi bazën e të cilit do të bëhet vlerësimi diakronik i shkallës së përputhjes së problemeve të zgjidhura me synimet ideologjike të shtetit.

Kriteri parë do të bazohet në *doktrinën epistemologjike të individualizmit antihistorik*; kriteri i dytë – në *doktrinën epistemologjike të holizmit dialektik*; ndërsa, kriteri i tretë – në *doktrinën epistemologjike të holizmit utopik*. Në bazë të kriterit të parë, progresi i kritikës letrare shqipe do të matet sipas masës së futjes në përdorim të metodave pa i përfillur fuqitë reale të tyre dhe pa e përfillur masën e nevojave për zgjidhjen e problemeve thelbësore, prandaj një kriter i tillë do të jetë në përputhje me reagimin ndaj nevojave ad hoc për zgjidhjen problemeve të njohjes letrare. Në rastin e dytë, progresi do të matet në masën se sa teoritë dhe metodat do të arrijnë t’i parashohin faktet e reja, të cilave, me potencialin e tyre, ato teori dhe metoda do të jenë të afta t’u përgjigjen, e jo të ndodh e kundërta: faktet e reja t’i demantojnë teoritë dhe metodat e zbatuara në një sistem njohjeje letrare. Ndërsa, në rastin e tretë progresi i kritikës letrare do të matet me masën se sa ajo do të jetë e aftë të kontribuojë në ndriçimin e aspekteve të veçanta, të pandriçuara deri në momentin e dhënë, të fakteve shoqërore (sintagmë terminologjike e përdorur nga Dyrkemi).

Për shkak se progresi, si botëkuptim për botën dhe si parim epistemologjik – në procesin e verifikimit të karakterit, të vëllimit dhe të cilësisë së koncepteve, të teorive, të metodave si dhe të marrëdhënieve të tyre për shpjegimin e fenomeneve letrare – kushtëzohet prej vizionit ndaj botës, si tititit filozofik, nuk mund të shpjegohet në bazë të *kritereve metodologjike*, siç

është kriteri i mundësisë së kontrollimit dhe të verifikimit apo të përgënjeshtimit të teorive e të metodave, por në bazë të *kritereve epistemologjike*, siç është kriteri i shkallës së qëndrueshmërisë, kriteri i shkallës së padëmshmërisë, kriteri i fuqisë së shpjegimit, kriteri i fuqisë së parashikimit, kriteri i fuqisë së të depërtuarit në thelbin e gjërave dhe i shkallës së përputhjes së teorive e metodave me vizionin e përgjithshëm ndaj botës, e me këtë edhe me shkallën e përputhjes së pikëpamjeve të caktuara për letërsinë, si pjesë përbërëse të atij vizioni.

Pse themi kështu?

Them i kështu sepse fuqia vepruese e teorive dhe metodave nuk mund të përcaktohet vetëm prej *lëndës* apo *aksiomave*, si përbërës të sistemeve të tyre, por prej konteksti epistemologjik, ku ato janë të vendosura dhe funksionojnë. Kështu mund të thuhet se parimit të totalitetit të një teorie dhe të një metode nuk mund t’i përgjigjen kategoritë e pjesës, siç ndodh me metodën e analizës dhe anasjelltas; parimit të zhvillimit apo të historicizmit nuk do të mund t’i përgjigjen kategoritë antihistoriciste të teorive e metodave imanentiste.

Një situatë e tillë çarjeje ndërmjet teorive dhe metodave, koncepteve, hipotezave dhe postulateve me përmbajtjen e vizionit, si pikënisje filozofike dhe epistemologjike, pashmangshëm subjektit njohës do t’i shkaktojë lëkundje botëkuptimore për natyrën e letërsisë, funksionin e saj dhe kriteret vlerësuese. Sabri Hamiti, bie fjala, duke pretenduar që të krijojë “një histori të letërsisë shqipe” (Hamiti, 1989: 9 – 10), që bazohet në analizën tematike të veprave të autorëve të veçantë të periudhave dhe fazave të ndryshme të zhvillimit të letërsisë shqipe dhe, në vend të parimit të historicizmit, duke zbatuar parimin e “shndërrimit të formave letrare” (thujse format letrare nuk janë të kushtëzuara historikisht), Lasgush Pogradecin do ta çmojë si një nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë shqipe, mu për shkak se poezia e tij nuk do të jetë “poezi e angazhuar” (Hamiti, 1978: 58, 61 – 62, 63, 64 – 65)<sup>41</sup>, por, në të njëjtën kohë, do ta vlerësojë lartë edhe krijimtarinë e Hivzi Sulejmanit mu për shkak të të qenit të tij shkrimtar i angazhuar (Hamiti, 1987: 195 – 210). Metoda e analizës tematike, që pretendon të krijojë “histori të formave letrare” do të përfundojë në

<sup>41</sup> Ky autor duke e vështruar kronologjinë e mendimit kritik shqiptar të shprehur për poezinë e Lagushit, do të mbajë qëndrim, në rastin më të butë, kritik e të shumtën, përçmues, për ata që vlerën e poezisë së Lasgushit në vend se ta kërkojnë në gjuhën poetike, e kërkojnë në thellësinë e ideve dhe të ndjenjave të shprehura, apo për të gjithë ata që kërkojnë që Lasgushi të “jetë i angazhuar” Shih. Sabri Hamiti, “Vdekja e Nositit” në Teksti i dramaturgjisë, Rilindja, Prishtinë, 1978 fq. 58, 61-62, 63, 64-65.

një karikaturë të historisë së letërsisë, ku Jeronim de Rada do hyjë si prijatar i avangardizmit (!) në letërsinë shqipe, ndërsa Fishta, Mjeda, Haxhiademi, Koliqi si shkrimtarë modernë (!) /Këto vlerësime për këta shkrimtarë Sabri Hamiti në mënyrë implicite do t'i shprehë në vitet '90-të dhe në mënyrë eksplicite në fillim të viteve 2000 në cilësinë e hartuesit të teksteve mësimore të lëndës së letërsisë shqipe/.

Ç'e shkakton një kaos të tillë epistemologjik e aksiologjik?

Në rrafshin metodologjik, doktrinën epistemologjike të individualizmit antidialektik do ta shoqërojë fenomeni i ambivalencës së përkufizimit të funksionit të saj si metodë e njohjes së drejtpërdrejtë empirike të vetive të veçanta të tërësisë së objektit njohës në njërin, dhe si metodë kalimtare prej metodës analitike në metodën sintetike, në anën tjetër.

Kritika letrare shqipe, e cila do të bazohet në doktrinën epistemologjike të individualizmit antidialektik, duke pasur për lëndë hulumtimi analizën parciale të karakteristikave dhe vetive të tërësisë së një objekti njohës, si e tillë, nuk do të mund t'i shërbejë procesit të kalimit epistemologjik të analizës në sintezë. Analiza e tillë do të jetë e paaftë që ta krijojë lidhjen ndërmjet metodës analitike dhe asaj sintetike deduktive. Rrjedhimisht, ajo nuk do të mund të japë një pamje të plotë për lindjen, zhvillimin, strukturat dhe proceset mbizotëruese me perspektivë historike për zhvillimin e letërsisë shqipe, si dhe nuk do të jetë e aftë ta zotërojë tendencën me perspektivën historike të proceseve, fenomeneve dhe strukturave letrare.

Për pakësimin dhe tejkalimin e mospërputhjeve të tilla kognitive subjektet njohëse "viktimë" të një mospërputhjeje të tillë, në rastin më të favorshëm të tyre, do të jenë të shtrënguar që t'i ndryshojnë qëndrimet e tyre teorike e metodologjike letrare (pse jo edhe ideologjike): imanentistët do të shndërrohen në pozitivistë e neopozitivistë, ndërsa pozitivistët në imanentistë /Ndryshimet e tilla të qëndrimeve dhe botëkuptimeve për letërsinë do të ndodhin gjatë viteve '90-të në Kosovë në rastin e parë, dhe në Shqipëri, në rastin e dytë/. Pikërisht kjo do të ndodhë me Sabri Hamitin: nga një imanentist i përbetuar në "Variante" të 1974-tës, në "Bioletra" (Hamiti, 2000:) do të "shndërrohet" në një neopozitivist pasionant.

### Përfundim

Historia e zhvillimit të shkencës letrare ka provuar se varësisht prej konceptimit të natyrës dhe funksionit të letërsisë janë përcaktuar këndvështrimet dhe interesat për njohjen e objektit letrar. Kështu, derisa në shek. XIX paradigma pozitivistë në qendër të interesimit të vet do ta ketë autorin, në fillim të shek. XX, kritika imanentiste – do ta ketë veprën. Ndërrimi e

paradigmave njohëse letrare do të jetë produkt i ndërrimeve të idealeve epistemologjike, të cilat, jo pak, do të kushtëzohen prej ndryshimeve të faktorëve shoqëroro-historikë. Ndërrimi i koncepcioneve për progresin, si botëkuptim për botën dhe si parim epistemologjik, do të ndikojë përcaktueshëm në përmbajtjen e idealeve epistemologjike.

Kështu, nëse themi se në kontekstin e botës bipolare, në vitet '70-të në Kosovë, doktrina epistemologjike letrare pozitivistë do të përballlet me arrogancën e doktrinës epistemologjike letrare imanentiste, që do të bazohet në teorinë dhe metodën e *kritikës së re*, në kontekstin e botës postbipolare, *kritika e re* përballë doktrinës së holizmit epistemologjik, që do të bazohet në teorinë dhe metodën e *historicizmit të ri* dhe në *teorinë e polisistemit*, do të përballlet me vetëdijen për vëllimin e vogël që ajo ka karshi vëllimit të zgjeruar të problemeve që kërkojnë zgjidhje në rrafshet interdisiplinare e transdisiplinare.

Për shkak se në fund shekullin XX dhe në fillim shekullin XXI, *njohja* gjithnjë e më shumë vështrohet e pa ndarë nga *praktika jetësore* dhe nga koncepti teorik për progresin e kësaj praktike, epistemologët letrarë, pas një kohe të zotërimit të paradigmes imanentiste, gjithnjë më shumë bëjnë fjalë për "periudhën postimanentiste", në të cilën ka hyrë shkenca letrare. Në lidhje me rikthimin e historicizmit dhe *historicizmit të ri*, si trajta të paradigmes postimanentiste që i kundërvihen *kritikës së re*, studiuesi amerikan Joseph Hillis Miller thotë se shkenca e letërsisë, pas disa vitesh ka përjetuar një ndërrim të papritur, nga teoria që drejtohej në gjuhën si të tillë, dhe analizën gjuhësore, do t'i kthehet historisë, kulturës, shoqërisë, politikës, institucioneve, kushteve të jetës, kontekstit shoqëror, bazës materiale (Miller, 1987: 281, 291).

### Bibliografia

- DELEUZE, Gilles dhe Guattari, Felix (2008), *Ç'është filozofia?*, Zenit, Tiranë.
- HAMITI, Sabri (1978), "Vdekja e Nositit" në Teksti i dramaturgjisë, Rilindja, Prishtinë.
- HAMITI, Sabri (1987), "Funksioni shoqëror i letërsisë", në *Njeriu kryengritës*, Rilindja, Prishtinë.
- HAMITI, Sabri (1989), *Vetëdija letrare*, Rilindja, Prishtinë.
- HAMITI, Sabri (2000), *Bioletra*, Faik Konica, Prishtinë.
- HURSEL, Edmund (1984), "Kriza e shkencës si shprehje e krizës radikale jetësore të njeriut evropian", në *Thema*, 3-4, 1984, Prishtinë.
- LINCOLN, S. Yvonna dhe GUBA, Egon (2000), »Paradigmatic Controversies, contradictions, and emerging confluences«, në: DENZIN, K. Norman dhe Lincoln, S. Yvonna, *Handbook of qualitative research*,

Hoxha

second edition, Thousand Oaks, London dhe New Delhi, Sage.

MILLER, Joseph Hillis (1987), *Triumph of Theory, the Resistance to Reading and the Question of the Material Base*, PMLA 102 (1987).

POPER, Karl (2003), *Mjerimi i historicizmit*, Onufri, Tiranë.